

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “ENERGY OF THE FUTURE” Sh.P.K

Në Tiranë, sot me datë 08.05.2023, me cilësinë e “Ortakut të Vetëm Themelues”:

Mimoza Haxhiu, e bija e Enverit e datëlindjes 28.02.1976, lindur në Ngjeqar te Fierit e banuese në Roskovec, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. 035129112, e cila në respektim të ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar me ligjin 129/2014, ligjt 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, hartoi aktin e themelimit, të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin **“ENERGY OF THE FUTURE” Sh.P.K**

KREU I

Neni 1

Krijimi Shoqërisë

Shoqëria **“ENERGY OF THE FUTURE” Sh.P.K** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“ENERGY OF THE FUTURE” Sh.P.K** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbalon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia e Shoqërisë

Shoqëria e ka selinë në Tirane, Njesia bashkiake nr. 1, Rr. Dalin Ndreu, Nr Pasurie 3/275/ND, Zona Kadastrale 8180.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, te hap zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë eshte ne fushën:

1. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e erës, termocentralet, biomasa etj.
2. Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmëse. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marjen e të gjitha lejeve,



licensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, institucionet përgjegjëse shteterore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në perputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursen Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit.

Përveç sa me sipër, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mësipërm. Për arritjen e qëllimit të mesipërm, Shoqëria mund të kryej çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. Duke përfshire por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe çdo aktivitet aksesor i lidhur me sa më sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime te tjera të tokes, punime civile, elektrike dhe mekanike të çdo lloji si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto çeshtje, gjithashtu dhe në fushën e aktiviteteve të tregtimit.

Neni 5
Kohëzgjata

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku me anë të vendimit te asamblesë së ortakëve.

**KREU II
KAPITALI**

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000(nje qinde mijë) lekë.

- Kapitali i shoqërisë përbëhet nga Një(1) kuote me vlere nominale sejçila kuotë 100.000leke.
- Kapitali themeltar i shoqërisë do te paguhet pas regjistrimit të shoqërisë në QKB .
- Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
- Sipas kontributeve të mesiperme Znj. Mimoza Haxhiui perket 1 kuote, qe i korespondon 100% e kuotave te kapitalit te shoqërisë .
- Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në sherbime, nëpërmjet emerimit të një eksperti të rregjistruar për këto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organë Vendimmarrës

Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Asambleja e Ortakut të Vetëm, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit

kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10
Administrimi

Administrator i shoqërisë është **Mimoza Haxhiu**, e bija e Enverit e datëlindjes 28.02.1976, lindur në Ngjezar te Fierit e banuese në Roskovec, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. 035129112.

Administratori i shoqërisë do të ushtroje kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejte ripërtëritje nga data 08.05.2023 deri ne 08.05.2028.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga vendimi i ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë ortakut për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e orakut edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.



Neni 12

Përgjegjësitet

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i shoqërisë që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

a) kthen ortakut kontributet;

b) paguan ortakut interesa apo dividendë;

c) i shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem te

Shoqërisë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqërisë "**ENERGY OF THE FUTURE**" Sh.p.k u redaktua me vullnetin te lire e te plete te "ortakut themelues", ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe

**ORTAKU
MIMOZA HAXHIU**

Mimoza Haxhiu 

